



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:187108

Datë: 29.11.2023

Numri i dokumentit: 04982492

P.nr.512/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Muhamet Musliu, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. K. nga fshati P. Komuna e P., për shkak të veprave penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të KPRK-së, dhe Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 374 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 5317/2023 të dt.31.10.2023, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më datë 27.11.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Rukije Sheshivari, përfaqësuesit të palës së dëmtuar –prindi i të ndjerës B. A. dhe i akuzuari me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. V. B., më datë 29.11.2023 mori publikisht shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A. K., nga babai B. dhe nënës S., e gjinisë M., i lindur me datë ... në fshatin Ll. në P., me vendbanim në rrugën “G. e Ll.”, në fshatin P. në P., me profesion mishtar, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, me numër personal ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak nga data 31.08.2023 deri me datë 05.10.2023.

Ë S H T Ë F A J T O R

S e p s e :

Me datën 31.09.2023, rreth orës 21:20 në rrugën nacionale Podujevë – Prishtinë, i pandehuri A. K. derisa ishte duke e drejtuar automjetin VW ..., ngjyrë hiri, me targa ... në shiritin e djathtë, nga pakujdesia ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 të Ligjit nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, ashtu që nuk ju ka kushtuar kujdes të duhur pjesëmarrësve në komunikacion e në këtë rast nuk ka pasur kujdes të duhur ndaj këmbësORES tani të ndjerës B. A. e cila në ato

momente ka qenë duke e kaluar rrugën nga e majta në të djathtë shikuar lëvizjen e automjetit si dhe nuk ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes automjetit ndaj kushteve të krijuara në komunikacion e dukshmërisë në rrugë që ishte errësirë dhe në momentin kur ju ka paraqitur rreziku nga aksidenti nuk ka mundur ta ndal automjetin me kohë pra çdo pengesë që ju ka paraqitur në rrugë me ç' rast me pjesën e parë të anës së djathtë të automjetit e ka goditur tani të ndjerën B. A. duke i shkaktuar lëndime vdekjeprurëse, me ç' rast e njëjta si pasojë e goditjes, ka ndërruar jetë në vendngjarje, bazuar në raportin e obduksionit ku është konstatuar se vdekja e cila ka ardhur si rezultat i gjakderdhjes masive në kokë dhe në abdomen, si pasojë e thyerjes së kockave të kapakut dhe bazës së kafkës dhe shqyerjes së shpretkës, si dhe këputjes së palcës kurrizore në nivel të unazës C-1 të shtyllës kurrizore, ndërsa tani e ndjera B. A. me atë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 142 pika 142.1 dhe 142.2 si dhe neni 143 pika 143.2 dhe 143.3 të ligjit nr.05/L-088 për rregullat e Trafikut Rrugor, përkatësisht tani e ndjera ka filluar të kaloj rrugën në mënyrë të pakujdesshme pa u siguruar mirë së një veprim i tillë mund të kryej në mënyrë të sigurt pa e rrezikuar vetën dhe pjesëmarrësit tjerë në trafik si dhe e ndjera ka filluar të kaloj rrugën jashtë vendkalimit të këmbësoreve.

- Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të KPRK-së.

Me datën, kohën dhe vendin e njëjtë si në pikën I të dispozitivit të kësaj kërkesë, i pandehuri A. K., nuk i ka ofruar ndihmë personit tjetër në aksident komunikacionit të shkaktuar me automjetin e tij, tani të ndjerës B. A., ndonëse gjatë vozitjes së automjetit e tij të tipi VW ..., ngjyrë hiri, me targa ..., e ka goditur atë duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse ku si pasojë e ndjera vdes në vendin e ngjarjes dhe menjëherë pas aksidentit i pandehuri nuk është ndalur për të i dhënë ndihmë tani të ndjerës por është larguar nga vendi i ngjarjes dhe ka shkuar në shtëpinë e tij dhe pas një kohe është lajmëruar në Stacionin Policorë në P.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 374 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Prandaj, Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 72, 76, 79, 370 dhe 374 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 242, 364, 365, 368, 369, 449, 452 dhe 462 të KPPRK-së i:

PËRCAKTON

Për veprën e parë si në dispozitivin në pikën I. me dënim me kusht, ashtu që i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, i cili dënim nuk do t'a ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej 3 (tre) viteve nuk kryen vepër të re penale, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Për veprën e dytë si në dispozitivin në pikën II. i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Konform nenit 79 të KPRK-së, të pandehurit në dënimin e shqiptuar me burgim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 31.08.2023 deri me datë 05.10.2023.

Konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dënimi i mbetur me burgim i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën **2,000.00€ (dy mijë euro)**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë

Me aplikimin e nenit 76 të KPRK-së e:

G J Y K O N

DËNIM UNIK ME KUSHT DHE GJOBË

I. Me dënim me kusht ashtu që i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej **dy (2) viteve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën e **verifikimit prej 3 (tri) viteve** nuk kryen vepër tjetër penale, si dhe dënim me gjobë në shumën prej **2,000.00 (dy mijë euro /€uro)**, të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

II. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mundet t'a paguaj dënimin me gjobë në afatin e lartcekur, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, atëherë Gjykata dënimin me gjobë do t'i zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20.00€ (njëzetë euro) të papaguara të gjobës, do t'i llogaritet nga 1 (një) ditë burgim.

III. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për ekspertizën e komunikacionit të paguaj shumën prej 300 (tre qind euro), për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

IV. I dëmtuari–prindi i të ndjerës B. A., babai B. A. nga fshati B. komuna e P. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 5317/2023 të dt.31.10.2023, kundër të akuzuarit A. K. nga fshati P. Komuna e P., për shkak të veprave penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të KPRK-së, dhe Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësinë e trafikut publik nga neni 374 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka treguar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më dt. 27.11.2023, në të cilën prezantuan Prokurori e Shtetit Rukije Sheshivari nga Prokuroria

Themelore në Prishtinë përfaqësuesi i palës së dëmtuar –prindi i të ndjerës B. A. dhe i akuzuari me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. V. B.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar i akuzuari lidhur me veprat penale që i vihen në barrë deklaroi: Së pari i kërkoj falje dhe i shprehi ngushëllime familjes Aliu për rastin që ka ndodhur, nuk kam pasur qejf që të ndodhë ky rast, pa pritur më ka dalur dhe nuk kam vërejtur asgjë dhe aksidenti ndodhi, e pranoj fajësinë. Është hera e parë që jam në gjykatë, ndaj e lus gjykatën që të më shqiptoi një dënim sa më të lehtë.

Mbrojtësi i të pandehurit av. V. B. lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij deklaroi: I mbrojturi im pas konsultimit paraprak me mua si mbrojtës lidhur me akuzën që rëndon mbi të njëjtin, e duke pasur parasysh benifitet që i parasheh legjislacioni penal për pranimin e fajësisë në stadin fillestar të një çështje gjyqësore, kemi vendosur që i njëjti ta pranoi fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar. Duke pasur parasysh rastin si ka ndodhur, shtuar faktin këtu edhe provat të cilat janë siguruar nga ana e Prokurorisë vërehet qartë një kontribut minimal i të mbrojturit tim për të ndodhur ky rast. Për më tepër i njëjti ka qenë duke drejtuar veturën e tij me shpejtësi rreth 55 km/h konform dispozitave të cilat parashihen për ngasje në atë rrugë, shtuar këtu edhe faktin tjetër se ajo është rrugë magjistrale e tipit të mbyllur ku nuk është e lejuar kalimi i këmbësorëve përveç në hapësirat të cilat janë të lejuara për kalimin e këmbësorëve, e që në rastin konkret tani e ndjera B. A. ka kaluar katër korsi të rrugës si dhe ndamjet fizike të hekurta dhe e ka goditur makinën të cilën ka qenë duke e drejtuar A. K. I mbrojturi im nga ky rast ka pësuar një tronditje të thellë psikike dhe emocionale që një gjendje të tillë e shprehu edhe në seancë, ku përveç kërkim faljes shprehi edhe ngushëllime dhe një pendesë të thellë që e paraqiti para të gjithë neve veçanërisht familjes së tij, shprehi dhe prezantoi më së miri situatën që i njëjti pa asnjë dashje ka kontribuar në shkaktimin e këtij rasti- aksidenti. Pra për të gjitha këto arsye kërkoj nga ana e gjykatës një dënim minimal për të mbrojturin tim i cili nuk do e rëndonte edhe më tepër gjendjen e tij. Përfundimisht po në ditën kur ka ndodhur rasti familja K. ka shkuar menjëherë te familja A. për kërkim falje, të njëjtit kanë qenë në varrimin e të ndjerës si dhe në shtëpinë e tyre për të shprehur ngushëllime, e që lidhur me këtë situatë në Prokurorin e shtetit kemi dorëzuar edhe parashitës të veçantë e cila e ka treguar një çështje të tillë.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga i pandehuri sepse ky pranim i fajësisë , ka mbështetje në shkresat e lëndës si dhe bazë ligjore në pajtim me dispozitat e KPK-së andaj i propozoj gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar prindi i të ndjerës B. A. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi: Sipas traditave familjare gjakun ja kemi falur, për dënim i`a lë gjykatës që të vendosë.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit, palës së dëmtuar, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.1 të KPP-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të

akuzuarve në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPP-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata e vërtetoi para se gjithash nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari, pranimi i cili ishte i vullnetshëm pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, dhe i mbështetur në të gjitha pikat e aktakuzës si dhe nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës si: Raporti i Autopsisë për të ndjerën B. A. nga Dr. M. G. e datës 31.10.2023 në bazë të urdhërësës së Prokurorit të Shtetit të datës 01.09.2023.

Ekspertiza e Komunikacionit e nxjerrë nga Eksperti R. B. e datës 10.09.2023 në bazë të aktvendimit të Prokurorit të Shtetit të datës 05.09.2023, Skica e vendit të ngjarjes, Foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes të datës 31.09.2023, si dhe shkresat e tjera të lëndës u vërtetua fakti se i akuzuari e ka kryer veprat penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprat penale e cila i vihet në barrë, ka kërkuar falje, për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, përgjegjësin e ndarë me rastin e aksidentit, ndërsa si rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj gjykata duke i vlerësuar këto rrethana gjykata ka zbatuar dispozitat për zbutje të dënimit konform nenit 72 të KPRK-së dhe ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak gjykata e ka marr konform nenit 79 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit, të dënimit me burgim në dënim me gjobë është marr në kuptim të nenit 44 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 2 pika 2.6 dhe 2.9 të KPP-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 36 par.3 nën par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.512/23, me dt.29.11.2023.

Sekretare juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.